
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA –SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA Zyra e Prokurimit	
---	---	---

NR:02/2018 Nr.prot:45/2018

Lënda Nr:025/2018

Për:	NTP AIT TOURS Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar Komuna Suharekë
Nga:	Mustafe Buzhala, Zyrtar i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për kërkesën për rishqyrtim të datës:23/07/2018 nga OE NTP AIR TOURS
Datë:	25/07/2018



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesa për ri-shqyrtim** e datës 23.07.2018 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik **NTP AIR TOURS**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti-Furnizim me material ndërtimor**, me Nr. Brendshëm 62418025121 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të **AIR TOURS** e datës: 23.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti-Furnizim me material ndërtimor**, me Nr. Brendshëm 62418025121, **“NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES”** të datës 19.07.2018, te publikuar ne platformen elektronike per ANULIM TE TENDERIT.

1. **Vërtetohet “VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES”** i datës 19.07.2018 i AK për Anulimin e **Procedures** i publikuar me datë: 19.07.2018,
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit duke eliminuar ngjarjet e pa parashikuara* ;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Procedura eshte anuluar sipas Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik neni:

44. Ndërprerja e procedurave të prokurimit

44.1 Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të dërgoj njoftimin tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.

44.7 Procedura e prokurimit *pas marrjes së ofertave duhet* të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit